

## **RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI : “Meremetim Muzeu Historik Qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropoje 2023”**



## **1. Pozicionimi**

Muzeu Historik i Qytetit te Bajram Currit ndodhet ne pjesen qendrore te qytetit ne anen perendimore te saj , ne bulevardin Binak Alia.

Ajo ndodhet ne koordinatat gjeografike perkatesisht  $42^{\circ}21'26''$  N  $20^{\circ}04'23''$ E



## **2. Të dhëna historike**

Muzeu "Bajram Curri" ndodhet në qytetin Bajram Curri në Rrethin e Tropojës. Quhet Muzeu Historik (i Tropojes)

Eshte projektuar nga Ark. Maksim Mitrojorgji, ndërtim i vitit 1985, i cili ka qenë ndër më të pasurit në vend,. Çelja e tij dhe data e inagurimit eshte 11 Janar 1988.

Eshte konsideruar si nder tre muzete me te mire historike ne Shqiperi. Në këtë muze kanë qenë të eksposuara relike të historisë të Shqipërisë veriore, Tropojës, Malësisë së Gjakovës dhe Kosovës. Objekte të veçanta, tashme të humbura, kanë qenë xhubleta 300-vjeçare e Nikaj Merturit, pasaporta originale e Bajram Currit e vitit 1924, djepi i shpuar nga plumbat në Bytyç në Luftën e Dytë Botërore, historiku i Tropojës dhe Kosovës, (material shkencor rrëth 300 faqe) etj.

Mjediset e këtij muzeu janë të bollshme dhe më se funksionale. Ka rrëth 8 salla ekspozimi për eksponatet muzeale, me një sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup>. Këto salla janë projektuar e realizuar në formën e rrathëve koncentrik dhe ka një ndarje të kateve në formë të tillë që kalon nga njëri kat në tjetrin pa u vënë re me 3-4 shkallë.

Ky muze është i vendosur në qendër të qytetit, i harmonizuar bukur me mjediset përreth, me përmendoren e Heroit të Popullit Bajram Curri, dhe në sfond me një copëz të bukurive të alpeve tonë, krijon një ansambël të vërtetë historiko-arkitekturor dhe një hijeshi të lakuueshme edhe për vizitorët.

Muzeu historik i Tropojës për peshën dhe vlerat muzeale e historike që mbart në gjirin e vet, për përmasat, zgjidhjen arkitekturore funksionale, do të hynte i treti në vendin tonë, pas muzeut kombëtar dhe atij të Skënderbeut ne Krujë.

## **3. Statusi**

Ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave me Nr.397 , date 01.06.2011 “ PER MIRATIMIN E LISTES PERFUNDIMTARE TE PRONAVE TE PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETERORE , QE TRANSFEROHEN NE PRONESI OSE NE PERDORIM TE BASHKISE BAJRAM CURRI TE QARKUT TE KUKESIT” eshte ne pronesi te Bashkise Tropoje duke u bazuar dhe ne Vertetimin Hipotekor me nr.05 date 25.11.2014 , per pasurine me nr 4/142 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 1347 e siperfaqe 2477 me ne adresen “ Lagjia partizani , Bajram Curri”.

#### **4. Qellimi i Projektit**

Qëllimi i kësaj ndërhyrje vjen si rezultat i nevojës për të rihapur për publikun këtë institucion, i cili pësoi dëme të shumta në vetratat e fasadës kryesore si pasojë e protestave të zhvilluara në datën 10.12.2020, dhe ku prej asaj dite muzeu ka qenë i mbyllur për publikun. Gjithashtu, sipas verifikimeve në terren, kërkohet të ndërhyhet në çatine e objektit pasi jane shume te vjetra dhe te amortizuara , ne gjendje te mjeruar , si dhe pjesa e tarraces qe eshte e demtuar qe kane nevoje per riparim pjesen e hidroizolimit, si dhe riparimi i instalimeve elektrike ku shumica e llampave , celsave dhe prizave jane ne prishura dhe nuk punojne.





## 5. Punime kryesore Ndertimore

Punimet Kryesore qe do te realizohen ne kete sallle ndahen ne 5 kategori

- Punime prishje ku perfshihen prishja e suvatimeve te mureve dhe tavaneve per shkak te armotizimit dhe jashte standardit per te funksionuar sipas kushteve teknike per rikthimin e riparimin e Muzeut Historik te Qytetit te Bajram Currit.
- Punime Elektrike ku perfshihen riparimi i linjave elektrike dhe vodosja e pajisjave elektrike si celsa, priza ,portollampa , kaseta plastike etj. per ndricimin e dhomave te brendshme dhe pjeseve te jashte te muzeut.
- Punimeve per riparimin e Çatise , per heqjen e derrasave te demtuara dhe te amortizuara dhe zevendisimin e saj me derrasa pishe te prere me sakice per kullimin e ujrave ne rast reshjeve ose me derrasa qe imitojne ato per te ruajtur ngjyrat , format dhe funksionin qe ka tani.
- Punime suva , bojatisje dhe veshje guri duke ruajtur ngjyrat , format dhe funksionin qe ka tani dhe rikthimin Muzeut Historik te Qytetit te Bajram Currit ne gjendje te mira .
- Punime ne pjesen e siperme e quajtur ne krahen tone "Baxhe" sipas skices ne projekt ka nevoje per riparimin e saj , vodosjen e xhamave ne pjesen e siperme pasi jane te thyera , riparimin e vetratave metalike dhe vodosje e grilave per mbrojtjen e saj nga demtimet e jashtme.Pjesa e poshtme si ne figure ka nevoje per heqjen e vodosjen e xhamave te reja te stilit " Peciklas" te cilat ndihmojne ne ndricimin e ambjentit te siper te muzeut , duke siguruar ndricimin natyror te saj.

GRUPI I PUNES  
Egzon Muhametaj

Hazir Isufaj

Muhamed Kuçana

